



UNIVERSITETI PUBLIK "KADRI ZEKA" UNIVERSITY
Zija Shemsiu, 60000, Gjilan, Kosovë
www.uni-gjilan.net tel: 0280390112

Vendimi nr. 01 / 1703 / Dt. 02 / 11 / 2020

Menaxhmenti i Universitetit "Kadri Zeka" në Gjilan, në përputhje me mundësitë dhe kushtet reale të krijuara pas rritjes së rasteve pozitive me Corona Virus COVID-19 dhe në përputhje me Vendimin e MSH të datës 31.10.2020 të rekomanduar nga Komitetit për vlerësimin dhe koordinimin e situatës pandemike merr

V E N D I M

1. Bazuar në vendimin e datës 31.10.2020 të Ministrisë së Shëndetësisë për masat anti-Covid 19 dhe vendimin e Senatit nr. 01/1521 dt.13.10.2020, menaxhmenti i UKZ-së vendosë që ligjëratat të organizohen vetëm në formën on-line.
2. Ushtrimet praktike ose laboratorike, konsultimet, provimet kolokviumet etj, të mbahen në prani fizike duke respektuar rekomandimet e MSH-së. Ligjëratat dhe ushtrimet të mos mbahen të njëjtën ditë.
3. Dekanët e njësive akademike të përgatisin oraret mësimore sipas këtij vendimi.
4. Personeli akademik dhe administrativ mbi moshën 60 vjeçare, gratë shtatzëna dhe personat me sëmundje kronike, nuk kanë obligim të paraqiten në punë deri në ndryshimin e rrethanave të krijuara nga pandemia. Detyrat e punës nga personeli që i takon kategorisë së të punësuarve si në këtë paragraf, deri në një vendim /njoftim tjetër do të kryhen nga shtëpia.
5. Menaxhmenti i UKZ-së obligohet që të ndërmarrë të gjitha masat për pajisje me dezinfektues të sallave apo laboratorëve ku do të mbahen ushtrimet praktike/laboratorike.
6. Ky vendim zbatohet nga data 02.11.2020 dhe vlen deri në marrjen e një vendimi tjetër.

REKTORI

Prof. Asoc. Dr. Bajram Kosumi

